

Bismilahi rrahmani rrahim

Prishtinë, 18.05.2008

Tema që më është dhënë për fjalimin e Xhalsës së sotme është **‘Çka i ka dhënë Ahmediati botës’**. Për t’iu përgjigjur kësaj pyetje duhet së pari ta dimë se në çfarë gjendje ishte bota, çka i mungonte asaj dhe për çka kishte nevojë ajo në kohën e ardhjes së themeluesit të Xhematit Ahmedia. Ajo, sipas Profetit të Shenjtë, Hazret Muhamedit^{sas}, do të ishte në një gjendje e mjerueshme dekadence të cilën ai e përshkroi me përpikëri 1400 vjet më parë. Sipas tij muslimanët e kohëve të vona do t’i jipnin përparësi botës materiale mbi botën shpirtërore, për të cilën gjë secili prej nesh jemi dëshmitar.

Ai thoshte se detyra kryesore e Mesihut të Premtuar^{ass}, i cili do të dërgohej në kohët e vona, do të ishte ringjallja e fesë, që do të thotë se në kohën e ardhjes së tij feja islame do të ishte degraduar në atë shkallë sa që do të mund të quhej e vdekur.

Në librin e tij ‘Fathe Islam’ në një poemë në persisht, Hazret Mirza Gulam Ahmedi, themeluesi i Xhematit Ahmedia, e përshkroi gjendjen e mjerueshme të muslimanëve të kohës së tij me këto fjalë:

I ka hije syrit të secilit besimtar të derdhë lot gjaku për gjendjen e mjerueshme në të cilën ka rënë Islami dhe për zhdukjen e muslimanëve të vërtetë. Ai, (është fjala për kritikët e Profetit të Shenjtë^{sas}) shpirti i të cilit është i privuar nga çdo gjë e mirë guxon t’i mveshë të gjitha llojet e defekteve më të mirit të Profetëve të Zotit. Ai i cili mbahet i burgosur në prangat e mëkatit i gjenë të meta karakterit të prijësit të të devotshmëvet. Një i mjerë e i lig i gjuan shigjetat e veta në të panjollin dhe të pamëkatshmin, sa që i ka hije qiellit të hedh gurë mbi tokë. Para syve tuaj Islami ka rënë përtokë. Me çfarë justifikimi do të dilni para Zotit o muslimanë, që e kaloni jetën tuaj në prehër të luksit? Mosbesimi po turret nga të gjitha anët si forcat e Jazidit, ndërsa besimi rrin shtrirë i pafuqishëm si Zeinul Abidini. Të pasurit janë dhënë pas kënaqësive duke e kaluar kohën e tyre në qeshje e thashetheme në shoqëri të bukurosheve. Ulematë ditë e natë rrinë duke u grindur për kotësira ndërsa fetarët janë krejtësisht injorantë ndaj kërkesave të fesë. O muslimanë, a janë këto shenjat e devotshmërisë suaj që duke e parë fenë të zhytur në këtë mjerim, ju jipeni me afsh pas ngordhësirës së botës?

Profeti i Shenjtë^{sas} gjithashtu ka thënë se në atë kohë muslimanët do t'i lënë pas dore pesë namazet ditore. Xhamitë do të jenë të shumta, por adhuruesit të paktë. Ai gjithashtu thoshte se namazi i muslimanëve të asaj kohe do të shndërrohej në një formë pa përmbajtje.

Ai gjithashtu kishte paralajmëruar se në kohën e ardhjes së Imam Mehdiut dhe Mesihut të Premtuar^{ass} asgjë nuk do të mbetet nga Islami përveq emrit të tij, dhe asgjë nuk do të mbetet nga Kurani përveç fjalëve të tij. Muslimanët do ta injoronin mësimin e Kuranit të Shenjtë por do t'i kushtonin rëndësi të madhe zbukurimit dhe dekorimit të tij duke e mbështjellur atë në kopertina mëndafshi.

E gjithë kjo është plotësuar në kohën e ardhjes së këtij Imami Hyjnor dhe është e pranishme edhe sot. Janë pak ata që thellohen në studimin e Kuranit dhe që dëshirojnë ta bëjnë atë udhërrëfyes të jetës së tyre. Një parashikim tjetër i Profetit të Shenjtë^{sas} ishte se në ditët e vona muslimanët do të ndërtonin xhami të shtrenjta dhe do të shpenzonin shuma marramendëse në dekorimin e tyre, në kundërshtim me thjeshtësinë, që duhej të ishte karakteristikë e faltoreve Islamike.

Profeti i Shenjtë^{sas} gjithashtu paralajmëroi se në ditët e vona arabët do të largoheshin shumë nga feja dhe nuk do të nxirrnin kurrëfarë dobie nga Kurani i Shenjtë. Gjendja prezente e shteteve arabe e dëshmon vërtetësinë dhe përmbushjen e kësaj profecie.

Kjo ishte gjendja e muslimanëve, por gjendja e pjesës tjetër të botës nuk ishte shumë më e mirë. Profeti i Shenjtë^{sas} kishte paralajmëruar përhapjen e pornografisë dhe paturpësisë deri në atë shkallë sa që njerëzit do të krenoheshin me mëkatet e tyre. Sot në kulturën e perëndimit e gjithë ajo që konsiderohet mëkat nga sheriati Islam është bërë kod i sjelljes shoqërore dhe mënyrë e civilizuar e jetës. Nuk ka nevojë të futemi në përshkrim të detajuar për diçka që na është e njohur të gjithëve. Marrëdhëniet jashtmartesore janë bërë aq normale sa që martesat janë duke u konsideruar si një pengesë dhe ndërhyrje në jetën shoqërore.

Transmetohet se Profeti i Shenjtë^{sas} gjithashtu kishte thënë se shenjë e afrimit të ditës së Gjykimit do të ishte se dituria e vërtetë do të zhdukej, injoranca do të mbizotëronte, imoraliteti do të rritej dhe dhënia pas alkoolit dhe lojërave të fatit do të bëhej diçka e zakonshme.

E gjithë kjo nuk ka nevojë për koment dhe ilustrime.

Devotshmëria, sinqeriteti, ndershmëria, besimi si dhe sjellja e mirë ndaj prindërve do të zhdukeshin pothuajse fare.

Pra, një botë kaq e prishur dhe e degjeneruar do të mund të reformohej vetëm nga një i dërguar i Allahut^{xhh}. Kur e filloi misionin e tij, Mesihu i Premtuar^{ass} pa se fatkeqësisht muslimanët po vuanin nga një numër i madh ideshë dhe besimesh të gabuara fetare. Njëri nga shërbimet më të rëndësishme ndaj kauzës së Islamit ishte pikërisht mënjanimi i këtyre ideve të gabueshme dhe mbjellja e dashurisë dhe e nderimit për Kuranin dhe Profetin e Shenjtë në zemrat e muslimanëve si dhe ngulitja e besimit të paluhatshëm dhe mbështetjes në Allahun e Madhërishtëm.

Një ose dy ilustrime të kontributit të tij në këtë drejtim mund të jenë të dobishme këtu. Sa i përket Kuranit, ai pa se muslimanët ndaheshin në dy grupe. Njëri grup e konsideronte Kuranin të shenjtë e patëmetë por i refuzonte të gjitha Hadithet pa përjashtim duke i konsideruar ato jo autentike dhe jo të besueshme dhe si të tilla jo të denja për burim udhëzimi. Grupi tjetër u jepte aq shumë rëndësi haditheve sa që pothuaj se i ngritte ato mbi Kuranin. Mesihu i Premtuar^{ass} i refuzoi të dy këto pozicione si extreme dhe të dëmshme. Ai theksoi se Kur'ani ishte fundamental dhe suprem ndërsa hadithet ishte një burim drite shumë i qmueshëm dhe udhëzim për të kuptuarit e drejtë të mësimëve Kuranore.

Në kohën e paraqitjes së Mesihut të Premtuar^{ass} njëri nga besimet e gabuara prezente ndër ulematë e gati të gjitha sekteve ishte se një numër i madh i ajeteve të Kuranit të Shenjtë, sipas disave deri në 600 syresh, ishin shfuqizuar nga ajete të zbritura më vonë. Ky ishte një gabim shumë i madh. Efekti logjik ishte se e shkatërronte besueshmërinë e Kuranit të Shenjtë dhe e bënte atë pre të kritikëve.

Mesihu i Premtuar^{ass} fuqishëm e hodhi poshtë çdo nocion të shfuqizimit, qoftë edhe të një ajeti, pjese të ajetit apo fjale të vetëme të Kuranit të Shenjtë duke i ftuar të gjithë ata që kishin ndonjë dyshim rreth kësaj qështjeje në dialog të hapur.

Një gabim tjetër shumë i madh në të cilin muslimanët kishin rënë qysh kohë para paraqitjes së Mesihut të Premtuar dhe ishin ngatërruar thellë në të, ishte besimi se Kurani i Shenjtë e kishte bërë të obligueshme përdorimin e forcës për përhapjen e Islamit.

Ky besim ishte një fyerje e rëndë ndaj Kuranit të Shenjtë dhe mësimave të tij, që nënkuptonte se Islami dhe mësimet e tij nuk kishin mundësi ta kënaqnin intelektin njerëzor dhe t'i bindnin njerëzit inteligjent që ta pranonin Islamin përmes kualiteteve të tija të brendshme të së vërtetës dhe urtësisë. Kurani ka vënë theks të veçantë në lirinë e vetëdijes dhe të besimit dhe proklamoi prerazi se 'Nuk ka dhunë në fe.'(2:57). përsëri thotë: 'Thuaj, kjo është e vërteta nga Zoti yt, pra, le të besoj ai që do dhe le të mos besoj ai që do.'(18:30).

Këto dhe shumë ajete të tjera të kësaj natyre nuk lënë pikë dyshimi se Kurani nuk lejon përdorimin e forcës të çfardo lloji qoftë për t'i detyruar njerëzit në pranimin e Islamit.

Xhahadi është fjalë arabe që nuk do të thotë luftë. Mund të përdoret simbolikisht edhe për t'iu referuar luftës, por kuptimi i saj i parë është përpjekje e skajshme. Qëllimi i luftërave të profetit të Shenjtë asnjëherë nuk ka qenë futja me forcë e njerëzve në Islam, por ato kishin kryesisht karakter mbrojtës.

Fatëkeqësisht, me kalimin e kohës, me rënien dhe venitjen graduale të vlerave shpirtërore dhe morale, filloi të fitohej përshtypja se ta detyrosh një jobesimtar duke ia mbajtur shpatën në fyt ta deklarosh veten musliman, ishte një sevab i madh madje ishte një obligim fetar për secilin musliman. Ky ishte një gabim tepër i madh dhe shumë i dëmshëm. Ajetet e cituara më lartë dhe shumë të tjera të kësaj natyre, vërtetojnë jashtë çdo dyshimi se asnjë lloj dhune nuk është e lejuar në Islam në qështjet e besimit.

Një herë, duke u kthyer nga një ekspeditë luftarake, kur Profeti i Shenjtë^{sas} me sahabët e tij po i afrohej Medinës, ai tha: 'Po kthehem nga xhahadi i vogël në xhahadin e madh'; që donte të thoshte se përpjekjet për reformimin shpirtëror ishin më të rëndësishme se lufta me armë.

Në këto rrethana, Mesihu i Premtuar^{ass} e pa si qenësore, që të spjegonte në mënyrë të detajuar konceptin e vërtetë dhe të drejtë të xhahadit mbështetur në mësimet e Kuranit dhe në praktikën e Profetit të Shenjtë^{sas}, por kjo solli si pasojë një kundërshtim të egër nga një pjesë e madhe e ulemave të asaj kohe. Ai gjithashtu u akuzua si fidan i mbjellur nga dora angleze i cili dëshironte ta shkatërronte Islamin nga përbrenda.

Shembujt e shpjegimit të doktrinave dhe mësimëve të rëndësishme Islamike të cilat i përmendëm më lartë janë vetëm një pjesës e vogël nga puna e tij e madhe në shërbim të kauzës së Islamit. Në shkrimet e tija voluminoze, në fjalimet dhe debatet e tija ai e bazonte gjithë atë që e thoshte në Kuranin e Shenjtë, në praktikën dhe në thëniet e Profetit të Shenjtë^{sas}. Volumet e shumta të shkrimeve të tij, fjalimet dhe bisedat përbëjnë një komentim të detajuar të Kuranit të Shenjtë që është një udhërrëfim i domosdoshëm për njerëzimin e erës që ka filluar me paraqitjen e tij.

Në njërën anë Mesihu i Premtuar^{ass} i largoi inovacionet dhe bestytnitë që po e rëndonin trupin e Islamit dhe po ia zinin frymën, dhe në anën tjetër i shpjegoi qartë mësimet e pastëra dhe të vërteta të Kuranit, përmes të cilave Islami dhe muslimanët mund të ringjallehin dhe të ktheheshin në forcën e plotë shpirtërore dhe morale.

Ai e ndaloi përdorimin e të gjitha praktikave që nuk ishin në përputhje me besimin në unikatësinë e Zotit dhe mësimet e Kuranit të Shenjtë dhe me praktikën e Profetit të Shenjtë^{sas}.

Muslimanët, si pjesa tjetër e njerëzimit, e kishin vënë të gjithë mbështetjen dhe shpresën e tyre në mjete materiale, duke e injoruar faktin se çdo e mirë vjen nga Zoti dhe se mjetet nuk duhet të ngriten në pozitën e burimit të vërtetë të të gjitha të mirave. Namazi dhe lutjet ishin shndërruar në një ceremoni të zbrazët formale dhe nuk shërbenin më si mjeti kryesor i afrimit me Zotit dhe i vendosjes së lidhjeve shpirtërore me Të. Mesihu i Premtuar^{ass} e vuri në pah rëndësinë e madhe të lutjeve për kultivimin e vlerave morale dhe shpirtërore duke i ilustruar mësimet e tij me shembullin e tij praktik.

Si rezultat ai arriti të themelonte një Xhematë, anëtarët e të cilit duke pasuar mësimet dhe shembullin e tij praktik, ilustruan në jetën e tyre të përditshme bukurinë e mësimëve Islame, sipas kapaciteteve dhe aftësive të tyre. Me plot gojën mund të thuhet se komuniteti të cilin ai e formoi është sot i vetmi që ilustron në jetën e shumicës së anëtarëve të tij qëllimin e vërtetë të jetës njerëzore dhe mënyrën e përfitimit të saj.

Por, t'i kthehemi edhe njëherë titullit të fjalimit i cili ishte 'Ç' i solli të re Ahmediati botës'? Përveç këtyre që u përmendën më lart dhe shumë të tjerave që për shkak të kohës nuk patën mundësi të përmendeshin, gjëja më e rëndësishme dhe më me vlerë që Ahmediati i solli botës është Sistemi i Kalifatit, të cilin bota islame kishte shumë kohë që e kishte humbur. Me

vdekjen e Hazret Aliut, fatkeqësisht muslimanët e humbën gjënë më të çmueshme që kishin - Kalifatin. Pati edhe më vonë mbretër dhe diktatorë që e quajtën veten kalifë, por kjo ishte asgjë më tepër se një fjalë goje, sepse të gjithë e dinë se kalifati i vërtetë kishte marrë fund me vrasjen e Hazret Aliut.

Është një rregull, që ndoshta jo të gjithë e dinë, se kur një herë kalifati ndërpritet, nuk mund të rifillohet përsëri pa intervenimin Hyjnor. Ai mund të vendoset vetëm pas vdekjes së ndonjë të dërguari të Allahut. Pra, për rivendosjen e kalifatit të vërtetë u desht që të pritej ardhja e Imam Mehdiut / Mesihut të Premtuar; dhe kështu ndodhi. Pas vdekjes së tij më 1908 filloi edhe njëherë një epokë e artë për muslimanët dhe edhe një herë u vendos Sistemi i mirëfilltë i Kalifatit. Kjo është pra dhurata më e çmueshme që Ahmediati i dha botës. Por, dhuratat shpesh dinë edhe të mos pranohen.

Profeti i Shenjtë^{sas} kishte thënë se pas tij do të vendosej Sistemi i Kalifatit i cili do të vazhdonte për 30 vjet e pastaj do të fillonte degradimi shpirtëror i muslimanëve derisa do ta arrinte kulmin në kohët e vona. Më pas ai thaj se sistemi i kalifatit, i bazuar në profetizëm, do të themelohej edhe një herë në ditët e vona, dhe pastaj heshti, pra nuk tha se ai do të pëfundonte. Allahu gjithashtu e kishte njoftuar themeluesin e Xhematit Ahmedia se kësaj radhe kalifati do të vazhdonte deri në ditën e Kijametit. Insha'allah.

Këtë vit, Xhemati Musliman Ahmedia në mbarë botën është duke e festuar 100 vjetorin e themelimit të sistemit të Kalifatit i cili u themelua fill pas vdekjes së themeluesit të Xhematit, Hazret Mirza Gulam Ahmedit^{ass}. Është një shekull rrite, suksesesh dhe përparimi në çdo sferë. Nga një qytezë e pa njohur e Indisë, drita e Islamit të vërtetë morri dhenë dhe tani Xhemati Musliman Ahmedia nën udhëheqjen e kalifëve të tij është themeluar në më shumë se 185 vende të ndryshme të botës. Tani Xhemati është duke përjetuar suksese të reja nën udhëheqjen e Kalifit të Pestë të Mesihut të Premtuar, Hazret Mirza Masrur Ahmedit.

Z. Musa Rrustemi

Fjalim i mbajtur me rastin e Xhalsa Salanës së tretë, 18 maj 2008-Kosovë